



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

12356
Nr. _____ prot.

Shkodër, më 06.09. 2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi “Për një ndryshim në VKB nr. 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023- 2025 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “ Për një ndryshim në VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë shkodër „i ndryshuar.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____prot.

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2023

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 71 DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË BASHKISË SHKODËR ” I NDRYSHUAR**

Këshilli i bashkisë Shkodër, sot në datë ____ . ____ . 2023, në mbështetje të neneve 40, 41, 54 germa ‘dh’, 55 pika 3 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ,të nenit 45 të ligjit nr.68/2017` Për financat vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 i ndryshuar , VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar, dhe sipas materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes ndërmjet programeve, të fondeve të trashëguara dhe të vitit 2023 , sipas pakësimeve sipas tabelës 1,2 dhe shtesave sipas tabelës 3 bashkëlidhur si dhe fish projekteve perkatese bashkelidhur per shtesat e fondeve referuar tabelës 3 .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



KRYETAR

Benat BECI

6370	Furnizimi me ujë dhe Kanalizime	231	-	-	-	-	-	-	-	1,463,250	1,463,250
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	231	-	-	52,843	-	-	-	-	-	52,843
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	231	-	1,079,642	183,792	-	-	-	-	-	1,263,434
9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	231	1,463,390	323,851	-	-	-	-	-	-	1,787,241
10430	Përkujdesja Sociale	230	155,573	-	-	-	-	-	-	-	155,573
10430	Përkujdesja Sociale	231	-	-	74,120	-	-	-	-	-	74,120
10661	Strehimi social	231	3,657	-	-	-	-	-	-	-	3,657
TOTALI SHPENZIME KAPITALE			8,044,407	1,403,493	257,912	52,843	-	-	-	1,463,250	11,221,905
TOTALI			88,953,610	2,685,649	3,242,666	74,405	397,754	382,631	1,027,298	1,463,250	98,227,263

KRYETAR

BENET BECI



TABELA 2

Pakësim viti 2023

Në lekë

Institucioni	Emërtimi i Aktivitetit	Programi	Kapitulli	Shpenzime operative	Investime	Totali 2023
Bashkia Shkodër	P01110.Q2.O2.A2.Sherbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës (si diferencë e prokurimeve)	1110	1	508,000		508,000
	P01110.Q2.O2.A2.Sherbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës (si diferencë e prokurimeve nga fondi i trashëguar)	1110	5	4,049,000		4,049,000
	P01110.Q2.O2.A16 Rikonstruksion i Dhomës së Serverave (si diferencë e prokurimeve)	1110	5		167,536	167,536
	P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjist së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)(si diferencë e prokurimeve)	1110	5		395,201	395,201
	TOTALI			4,557,000	562,737	5,119,737

KRYETAR

BENEFICI




TABELA 3

Shitesa viti 2023

Në lekë

Institucioni	Emërtimi i Aktivitetit	Paga	Sigurtime	Shpenzime operative	Investime	Totali 2023	
Bashkia Shkodër	P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (shitesë)				10,000,000	10,000,000	
	P01110.Q2.O2.A18 Blerje automjete/vctura elektrike dhe biçikleta elektrike për administratën e Bashkisë Shkodër				15,000,000	15,000,000	
	P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. (shitesë)	2,624,000	418,000				3,042,000
	P04520.Q1.O1.A1 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shitesë)				1,512,000	35,604,000	37,116,000
	P04570.Q1.O1.A1 Lëvizshmëria dhe sinjalistika (shitesë)					12,720,000	12,720,000
	P06260.Q3.O1.A1 Shërbimi i Sistemit të Ndrëimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative (shitesë)				1,008,000	9,000,000	10,008,000
	P08220.Q1.O3.A14 "Ndërmendje" (shitesë)				700,000		700,000
	P08220.Q1.O3.A42 "100 vjetori i Simon Gjionit"				300,000		300,000
	P08220.Q1.O3.A43 "Festivali Muraleve Realizimi i muraleve"				800,000		800,000
	P08220.Q1.O3.A44 "Shkoda qyteti i festave"				2,000,000	1,500,000	3,500,000
	P08220.Q1.O1.A1 "Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik (shitesë)				1,000,000		1,000,000
	P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë" (shitesë)				700,000		700,000
	P09120.O3.A6 Ndërtim- shitesë e godinës për shkollën Ismet Sali Bruçaj. Guçi e RE, Njësia Rethina (shitesë)					8,461,000	8,461,000
	TOTALI		2,624,000	418,000	8,020,000	92,285,000	103,347,000



KRYETAR

BENET BECI

Zv. Kryetar

Zv. Kryetar

Drejtoria e te Ardhurave

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Enke Hexhi

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes se
investimeve të Infrastrukturës

Alfred Sulata

Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Floris Ablocoj

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

A. Peraj

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimit te AMTP

Alban Selaj

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Terrritorit

Policia Bashkiake

Elton Myrtaj

Drejtoria e Administrimit te Sistemeve
Menaxhimit te ZIN, Projekteve dhe Menaxhimit
te Sistemeve te Informacionit

Genald Prashi

Drejtoria e Financës

Drejtoria Juridike

B. Jorgos

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe
Sportit

Ala Juri

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe
Strehimit

Elvir Kacemi

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe
Menaxhimit të Ujërave

Fida Sullaku

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve

Ergon Dikveraj

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Jasmine Ollari

Drejtoria e Turizmit

Për / Jorida Kufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____prot.

Shkodër, më _____. 2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi “Për një ndryshim në VKB nr. 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023- 2025 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “ Për një ndryshim në VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë shkodër „i ndryshuar.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

“Për një ndryshim në VKB nr. 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023- 2025 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore”; të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, të ndryshuar ; Udhëzimin Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të ndryshuar Bashkia paraqet disa ndryshime në buxhetin e saj ku përfshihen shtesa, pakësime dhe rialokime të fondeve të trashëguara nga viti 2022 dhe vitit 2023 ne programet si me poshte :

1. Politikat e Qeverisë Shqiptare mbi angazhimin e saj për të qënë pjese e Konventës Kuadër të

Kombeve të Bashkuara ku edhe Shqipëria është nënshkruese e kësaj Konvente.

Vetë Kushtetuta e jonë ka të përfshirë “ një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tashëm e të ardhshëm” .

Nisur nga sa më sipër është një detyrim ligjor i bashkive në kuadër të ligjit Nr. 124/2015 “Për eficensën e energjisë” i ndryshuar , Ligjit nr 155/2020 “ Për ndryshimet klimatike” të marrin pjesë në mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi si detyrim ligjor edhe i funksioneve të saj , por nëpërmjet investimeve të saj të kursejnë energjinë detyrimisht zvogëlojnë emetimet e CO2 në ambjent.

VKM nr 872 dt 29.12.2021 “ Për miratimin e planit kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2030 “ parashikon edhe marrjen e masave nga të gjithë institucionet për zbatimin e tij. Nje nga Masa është edhe Eficienca e Energjisë në Transport / si edhe rritja e Përqindjes së Automjeteve në Flotën kombëtare të Transportit.

Bashkia Shkodër në kuadër të projektit “ Bashki me Shfrytëzim inteligjent energjie” në bashkëpunim me specialistët zviceranë eshte duke hartuar “ Planin Lokal për Energji dhe Klimë”, plan i cili brenda muajit

tetor do te vijë pranë këshillit të Bashkisë për shqyrtim. Ky plan një nga objektivat kryesore për zbatim ka edhe Eficiencën e energjisë në fushën e transportit në përgjithësi dhe atij publik/bashkiak në vecanti.

Për të përmbushur këto objektiva që janë pjesë e Politikës së bashkisë në fushën e transportit / mbrojtjes së mjedisit dhe eficiencës së energjisë parashikon blerjen e 4 automjeteve elektrike për administratën e bashkisë si edhe blerjen e disa bicikletave elektrike , po per kete administrate. Bashkelidhur fishe propozimi **P01110.Q2.O2.A18 Blerje automjete/vetura elektrike dhe bicikleta elektrike për administratën e Bashkisë Shkodër** me burim financimi te trasheguara nga viti 2022 me vlere 15 000 mije.

2. Në buxhetin e vitit 2023 janë parashikuar shpenzime për objektin: “ Blerje pajisje të teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) . Duke patur parasysh rritjen e çmimeve bazuar në testimin e tregut , amortizimit të paisjeve ekzistuese si edhe nevojave të vazhdueshme të administratës për rinovimin e paisjeve të ndryshme të zyrave si Kompjuterat, printera, laptop dhe rezulton që buxheti i parashikuar për vitin 2023 është i pamjaftueshëm.

Për këtë qëllim kërkohet një shtesë fondi në vlerën prej 10,000,000 lekë. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI-t për Komunikimet Elektronik, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike. Gjithashtu faktor kryesor eshte plotesimi i shumë vendeve vakante që kërkojnë rritjen e numrit të paisjeve TIK. Nevoja për blerje për një WorkStation për drejtorinë e Medias është imediate pasi paisjet aktuale (aparate fotografik,dron,videokamera) prodhojne material ne cilësi shumë të larta dhe rezolucion me kapacitet të madh.Kompjuterat aktual të Drejtorisë së Medias nuk janë ne gjendjen optimale për të realizuar punën ne cilësi dhe në kohë.Gjithashtu do të blihen disa printera pasi për shkak të volumit të punës shumë prej tyre kanë patur defekte të ndryshme.Duke parë gjendjen aktuale të kompjuterave në cdo zyrë,është e nevojshme patjetër rinovimi i tyre në një masë të konsiderueshme.Duhet gjithashtu paisja me disa laptop për përdorim në aktivitete të ndryshme brënda dhe jashtë ambjenteteve të Bashkisë.Duhet llogaritur gjithashtu rinovimi i disa kompjuterave në njësite administrative. Bashkangjitur keni fishen për këtë projekt. Bashkelidhur fishe propozimi **P01110.Q2.O2.A11.Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (shtese)** me burim financimi te trasheguara nga viti 2022 dhe rialokim te fondeve te vitit 2023 (diference fondesh nga prokurimet) me vlere 10 000 mije leke.

3. Policia Bashkiake Shkodër ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 2003 me një efektiv prej 17

punonjësish, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 313 datë 01.07.2002. Në gusht të vitit 2015, pas Reformës Territoriale, numri i popullsisë në Bashkinë Shkodër është rreth 204.954 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodërs me 55% të popullsisë (114.085 banorë) ndërsa pjesa i përket njësite administrative që tashmë janë pjesë e Bashkisë Shkodër, njësia më e madh është ajo e Rrethinave me 23.923 banorë, Guri i zi me 11.838 banorë, Postriba me 11.730 banorë, Bërdica me 9.655 banorë, Velipoja me 9.574 banorë, Dajci me 8.998 banorë, Ana e Malit me 5.968 banorë, Pulti me 3.249 banorë dhe Shalë e Shosh me 5934 banorë.

Aktualisht në varësi të problematikave që ka territori i Bashkisë Shkodër, si zënia e hapësirave publike, tregtia e paligjshme, ndotje mjedisi, ndërtime pa leje, prishje të qetësisë publike etj, me këtë numer punonjësish që ka ky shërbim, duke llogaritur kohën e punës 40 orë punë në javë, pushime javore, leje vjetore dhe ndonjë raport mjekësor, mbulojnë vetëm shërbimet e turnit të parë e të dytë kryesisht në tregjet e qytetit.

Nisur nga mësipër, me qëllim rritjen në një shkallë më të lartë të shërbimeve të Policisë Bashkiake ndaj komunitetit, si dhe të përmbushë me sukses detyrat e saj funksionale, mendojmë se duhet të shtohet numri i punonjësve të Policisë Bashkiake, Bashkelidhur fishe propozimi **P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. (Shtese)** me burim financimi te trasheguara nga viti 2022 me vlere 3 042 mije leke.

4. Bashkia e Shkodrës në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetesës për qytetarët kryen funksionet e veta në infrastrukturë dhe shërbime publike ku nevojat në shërbim të banorëve në të gjithë territorin e Bashkisë. Megjithë përpjekjet në rritje për përmirësimin e këtyre shërbimeve dhe punëve publike nuk jemi në nivelin e pritshmërisë së qytetarëve në të gjithë territorin në Qytet dhe Njësi Administrative. Ndër arsyt kryesore është për shkak të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve teknike, mjeteve të punës, dhe burimeve njerëzore. Për të përmirësuar këtë situatë në mënyrë të ndjeshme, është e domosdoshme përmirësimi i këtyre kapaciteteve në sektorët si më poshtë.

➤ **P04520.Q1.O1.A1 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës.**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015, datë 17. 12. 2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pushteti vendor është përgjegjës për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore. Gjatësia totale e rrjetit rrugor që mirëmbahet në qytet është 202 km. Me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shtimin e sipërfaqes së shërbimit në rrugë e trotuare, është e nevojshme fuqizimi me kapacitete të mjeteve dhe pajisje.

Me synim përmirësim rrenjësor të mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuarëve në territorin e Bashkisë do të realizojmë shërbimet me kapacitete teknike dhe fuqi punëtore të vetë Bashkisë. Kjo do të bëjë të mundur realizimin e shërbimeve me kosto më të ulët, ofrim më të shpejtë të shërbimit për shkak të reduktimit të procedurave si dhe shërbim të vazhdueshëm gjatë të gjithë vitit në të gjithë territorin.

Punët dhe shërbimet publike që parashikohen të realizohen janë:

Mirëmbajtje rrugë me asfalt, mirëmbajtje trotuare me pllaka betoni, mirëmbajtje pedonale me pllaka guri, mirëmbajtje kanalizime të ujrave të bardha, pastrim i kanaleve të hapura të ujrave të bardha, riparim e zëvendësim të pusetave e gradelave ujëmbledhëse, riparim të kunetave etj. Krahas këtyre punimeve e shërbimeve mjetet e transportit do të shërbejnë edhe për punë të tjera sipas nevojave që do të ketë bashkia.

Për të realizuar këto shërbime kërkohet përmirësimi e kapaciteteve teknike, mjeteve të punës dhe veshje për punonjësit si më poshtë:

Blerje automjete

- Kamionçine 5 vendesh, veteshkarkus, 3-5 ton (3 copë)
- Kamionçine, veteshkarkus, 3-5 ton (2 copë)
- Kamionçine, 2.5 ton (1 copë)
- Kamion vetëshkarkus 8 m3 (1 copë)
- Kamion veteshkarkues me vinç 10 ton (1 copë)
- Fadrome (1 copë)
- Eskavator me goma me krah te gjate, tip Benati (1 copë)
- Asfalto shtruese, me hapje 2-5 m (1 copë)

- Rrul i vogel deri ne 2 ton (1 copë)
- Mjet zhblllokues per kanalet (1 copë)

Blerje mjete pune

- Rrul dore me motorr me benzine (1 copë)
- Moto-betonier 0.25 m3 (1 copë)
- Tokmak dore me motorr (1 copë)
- Matrapik i madh (3 copë)
- Çisterno uji 5 m3 (1 copë)
- Pistolete lavazhi per larje puseta rruge (1 copë)

Blerje veshje për punëtorët

- Veshje për punëtorët që punojnë jashtë, komplet veror (60 copë)
- Veshje për punëtorët që punojnë jashtë, komplet dimeror (60 copë)

Bashkelidhur fishe propozimi **P04520.Q1.O1.A1** **Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtese)** me burim financimi te trasheguara nga viti 2022 me vlere 37 116 mije leke.

➤ P04570.Q1.O1.A1:Lëvizshmëria dhe Sinjalistika.

Në kuadër të politikave të Bashkisë në fushën e mobilitetit, për përmirësimin e lëvizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë, megjithë përpyekjet që janë bërë ka nevoja të rritjes së kapaciteteve për një shërbim më të mirë. Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe përmirësimi i saj rrit sigurinë për këmbësorët, përdoruesit e bicikletave, përdoruesit e mjeteve të qytetarëve me aftësi ndryshe. Për të arritur në nivelin e pritshmërisë së qytetarëve është e nevojshme rritja e cilësisë së shërbimit për mirëmbajtje dhe zgjerim të shërbimeve në qytet dhe Njësi Administrative me sinjalistikë horizontale dhe vertikale.

Punët dhe shërbimet publike që parashikohen të realizohen janë:

Mirëmbajtje sinjalistikë rrugore horizontale dhe vertikale, shtim i sinjalistikës sipas nevojave në përshtatje me planet e lëvizshmërisë dhe parkimeve, transporti me mjete i punonjësve me paisje dhe materialet e nevojshme për realizimin e punëve dhe shërbimeve, në qytet dhe Njësitë Administrative. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet shtimit të kapaciteteve të mjeteve dhe pajisjeve dhe sigurinë në punë të punonjësve si më poshtë:

Blerje automjete

- Foristradë me karroceri (Pickup) (2 copë)
- Makine vijezi (1 copë)

Blerje mjete pune

- Prerese asfalti me motorr me benzine (1 copë)
- Matrapik i vogel (2 copë)
- Saldatriçe me gjenerator (2 copë)

- Saldatriçe (2 copë)
- Moto-gjenerator (1 copë)

Bashkelidhur fishe propozimi **P04570.Q1.O1.A1: Lëvizshmëria dhe sinjalistika (shtese)** me burim financimi te trasheguara nga viti 2022 me vlere 12 720 mije leke.

➤ **P06260.Q3.O1.A1: Shërbimi i Sistemit të Ndricimit Publik të Qytetit dhe Njësive Administrative**

Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe permiresimin e ndricimit të mjediseve publike. Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit. Shërbimi mirëmbajtjes së ndricimit publik mbulon të gjithë territorin e të qytetit dhe në Njësi Administrative aty ku është realizuar ndricimi përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndricimit në qytet dhe në njësi administrative ku përfshihen, ndricimi i rrugëve kryesore dhe dytësore, ndricimi i shesheve, ndricimi i parqeve dhe lulishteve.

Garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe permiresimin e ndricimit të mjediseve publike. Rritja e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit

Aktivitetet kryesore ne këtë sektor janë shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit të ndricimit publike, realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative shërbimet e mirëmbajtjes për dy autovinça me të cilet mbulohet me shërbim i gjithë territori i bashkisë. Këto mjete shërbejnë edhe për dekorin e qytetit në raste festash dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga Bashkia. Zgjerimi i linjave të ndricimit publik gjithnjë në rritje nga investimet e shtuara, në rrugë, sheshe e lulishte paraqet vështirësi me mjetet dhe paisjet që kemi në dispozicion. Është e mnevojshme rritja e kapaciteteve logjistike për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit si dhe sigurinë e punonjësve.

Me synim garantimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin jetesës së qytetarëve dhe permiresimin e ndricimit të mjediseve publike, rritjen e efijencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë si dhe zgjerimit të zonës së shërbimit kërkohet të realizohen blerjet si më poshtë:

Blerje automjete

- Kamion me vinç me kosh (1 cope)
- Foristrade me karroceri (Pickup) (2 cope)

Blerje veshje për punëtorët

- Veshje për punëtorët që punojnë jashtë, komplet veror (40 copë)
- Veshje për punëtorët që punojnë jashtë, komplet dimeror (40 copë)

Bashkelidhur fishe propozimi **P06260.Q3.O1.A1: Shërbimi i Sistemit të Ndrëimit Publik të Qytetit dhe Njërive Administrative (shtese)** me burim financimi te trashëguara nga viti 2022 me vlere 10 008 mije leke.

Me synim përmirësimin e këtyre shërbimeve në funksion të cilësisë së jetës së qytetarëve, efikasitetit në ofrimin e shërbimit, kushte më të mira pune dhe rritje të sigurisë për punonjësit propozojmë realizimin e shpenzimeve për blerje automjete, mjete pune dhe veshje për punëtorët si më poshtë:

000/Lekë				
Nr	Programi	Emërtimi	Artikulli 602 Mallra dhe Shërbim	Artikulli 231 Shpenzime Kapitale te Trupezuara (Investime)
1	04520	Blerje automjete		33,840
		Blerje mjete pune		1,764
		Blerje veshje për punëtorët	1,512	
2	04570	Blerje automjete		9,600
		Blerje mjete pune		3,120
3	06260	Blerje automjete		9,000
		Blerje veshje për punëtorët	1,008	
		Totali	2,520	57,324

Burimi i financimit prej 59,844 mijë lekë propozojmë të jetë nga fondet e trashëguara nga buxheti i Bashkisë Shkodër i vitit 2022.

5. **Bashkia shkodër ne kuader te ridimensionimit te aktiviteteve te parashikuara per vitin 2023** propozon disa ndryshime dhe shtesa ne fishat e buxhetit te programit 8220. Drejtoria e kulturës, arsimit, rinisë dhe sportit synon të rrisë cilësinë e aktiviteteve kulturore dhe artistike që do të zhvillohen në vazhdim. Nisur nga kjo lind nevoja e financimit te shpenzimeve si me poshte:

Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, propozon:

Fishe P08220.Q1.O1.A1 “Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit” Ekspozitë me karakter historik dhe artistik (shtese) propozojme te shtojme aktivitetin A2.Video promovuese me vlere 1 000 000 leke, me qellim shtimin e vlerave dhe permasave te ketij aktiviteti.

Çdo vit, në vazhden e përkujtimit të festave të nëntorit, Muzeu Historik Shkodër organizon aktivite, duke iu bashkëngjitur eventeve të kthyer tashmë në traditë. Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit organizohet nga Bashkia e Shkodrës me përfshirjen e institucioneve të kulturës, organizata e qytetarë.

Per vitin 2023 po planifikojme nje ekspozite me arme te luftes se pare Boterore e ne vazhdim ,arme te cilat jane pjese e fondit te arkivit te Muzeut Historik Shkodër.

Drejtoria e Kulturës, me qëllim promovimin e këtij aktiviteti do realizohet një video promovuese Shkodër – Kosovë dhe realizimi koncertit të Orkestrës Sinfonike me këngë qytetare shkodrane.

Fondi shtese eshte planifikuar te merret nga fondet e trashëguara te vitit 2022, bashkelidhur ketij relacioni gjeni edhe fishe e re.

Fishe P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë” (shtese) propozojme te shtojme

vleren e aktivitetit ekzistues A5. Honorare, Instrumentist, 28 persona x 25,000 lekë me **700 000 leke**. Meqenese festivali eshte i shtrire pergjate 3 neteve e shohim te nevojshme ritjen e numrit te instrumentisteve te rinj qe do te mbeshen.

Nisma për organizimin e këtij Festivali synon ruajtjen e vlerave të muzikës qytetare dhe pasurimin e saj me repertor të ri. Festivali “Luleborë”, ka si qëllim t’i japë një dimension të ri këngës qytetare, duke ruajtur vazhdimësinë e një tradite të hershme dhe me shumë vlerë për qytetin e Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë.

Duke parë forcat krijuese dhe interesimin e madh qytetar për këtë Festival, ai është në vendin që i takon, në Shkodër. Festivali “Luleborë” ka gjithëpërfshirje të krijuesve në muzikë, tekste, orkestrime dhe interpretim.

Krijimtaria dhe interpretimi do të vlerësohen nga një juri e përbërë nga personalitete të fushës së artit.

Fondi shtese eshte planifikuar te merret nga fondet e trasheguara te vitit 2022, bashkelidhur ketij relacioni gjeni edhe fishen e re.

Fisha P08220.Q1.O3.A14 “Ndërmendje“ (shtese) propozojme te shtojme vlere tek aktiviteti ekzistues A1. Zhvillimi i aktivitetit “Ndërmendje“ vleren prej **700 000 leke**, me qellim shtimin e vlerave dhe permasave te ketij aktiviteti.

“Ndërmendje” është aktivitet, icili përfshin të gjithë artistët e kualifikuar të qytetit të Shkodrës dhe jashtë tij. Ruajtja e kësaj tradite, e bën Bashkinë Shkodër pjesë të modelit më të mirëtë vendeve europiane, të cilat realizojnë çdo vit koncertin e fundvitit. Eksperienca ka treguar që ky projekt kulmon festimet e fundvitit dhe ka pjesëmarrje të gjerë të spektatorëve. Nga eksperienca e viteve të tjera mund të thuhet që “Ndërmendje” është një ndër aktivitetet më të rëndësishme të vitit, sepse përfshin një masë të gjerë të institucioneve kulturore dhe pothuajse të gjithë artistët e qytetit tonë dhe jo vetëm.

Fondi shtese eshte planifikuar merret nga tepricat buxhtore te vitit 2022, bashkelidhur ketij relacioni gjeni edhe fishen e re.

Gjithashtu lind nevoja e organizimit te dy aktiviteteve te reja si per 100 vjetorin e kompozitorit te nderuar Simon Gjonit dhe per Festivalin e muraleve.

Propozojme te shtojme fishen P08220.Q1.O3.A42 100 vjetori i Simon Gjonit me vlere 300 000 leke.

Drejtoria e Kulturës dëshiron të përkujtojë kompozitorin e nderuar Simon Gjonit i cili kontribuoi si drejtues i shumë formacioneve të ndryshme orkestrale dhe vokale të qytetit të Shkodrës. Me një sensibilitet dhe origjinalitet të dukshëm në kompozicion ai krijoi në vite një seri këngësh të paharruara që shquhen sa për ndjeshmërinë e tyre sa poetike aq edhe të singerta, të figurshme dhe fisnike si, "Lule bore", "Sy larushes", "Sytë e tu si drita", "Fyelli i çobanit", "Nëna dhe çika". Simon Gjoni, është një ndër dirigjentët e parë të orkestrave tona simfonike të Teatrit të Operas dhe Baletit dhe të Radio-Televizionit Shqiptar. Ne vitin 1958, kur u emërua dirigjent në TOB, shumë vepra të shquara e gjetën interpretimin e "parë" tek dirigjenti i ri, i cili i interpretoi ato duke zbuluar ngarkesën emocionale të tyre me një ndjeshmëri të lartë. Përmendet baleti "Lola", "Laurencia", operat "Don Paskuale", "Berberi i Seviljes", "Paliacot", "Franceska da Rimini", "Pranvera", etj.

Sa më sipër bashkia Shkodër për 100 vjetorin e lindjes do realizojë një ekspozitë promovuese monografie me ceremoni vlerësimi për këtë këtë figurë të shquar të qytetit tonë.

Fondi shtese eshte planifikuar merret nga fondet e trasheguara te vitit 2022, bashkelidhur ketij relacioni gjeni edhe fishen e re.

Propozojme te shtojme fishen P08220.Q1.O3.A43 Festivali Muraleve Realizimi i muraleve me vlere 800 000 leke.

Muralet janë kthyer në atraksionin më të ri turistik në disa qytete të vendit, ku syri kureshtar i qytetarëve mahnitet nga ngjyrat, ndërthurja e elementëve dhe sidomos nga mesazhet që transmeton ky art. Këtë vit edhe në Shkodër një hapsirë e vecante do të dedikohet artisteve të rinj të cilët do të realizojnë piktura murale në zona të ndryshme të qytetit si ato industriale, duke i dhënë një pamje të re asaj zone. Dy aktivitete të parashikuara në këto fise janë A1. Blerje të materialeve të ndryshme me vlere 300 000 leke dhe A2. Honorar për 8 artist street art me vlere 500 000 leke

Fondi shtese është planifikuar të merret nga fondet e trashëguara të vitit 2022, bashkelidhur këtij relacioni gjëni edhe fishen e re.

Propozojme te shtojme fishen P08220.Q1.O3.A44 “Shkodra qyteti i festave” me vlere 3 500 000 leke.

Për festat e fundvitit sheshi i pedonale së qytetit do jetë qendra e festave të fundvitit në Shkodër. Një ambient i improvizuar me shtëpiza druri, të cilat do vendoset në pedonalen e qytetit do krijojnë një atmosferë festive me muzikë, ekspozitat pikturë, kartolina dhe panairët artizanale.

Festimet e shumta rreth shtëpizave të drurit, ceremonia e ndezjes së dritave në qytet, dekorimet dhe dhuratat e bëjnë këtë periudhë të vitit shumë të veçantë. Kjo atmosferë festive që përjetojnë fëmijët dhe të rriturit gjatë këtyre festave është një vlerë e shtuar për qytetin e Shkodrës. Fisha ka në përberjen e saj dy aktivitete A1. Aktivitete për fëmijë e të rritur, muzikal festiv për fëmijë, koncerte në shesh gjatë muajit festiv me vlere 2 000 000 leke dhe A2. Blerje e shtëpizave për aktivitete promovuese me vlere 1 500 000 leke

Fondi shtese është planifikuar merret nga fondet e trashëguara të vitit 2022, bashkelidhur këtij relacioni gjëni edhe fishen e re.

Tabela 3 – Shtesa viti 2023 është si me poshte:

Në lekë						
Institucioni	Emërtimi i Aktivitetit	Paga	Sigurime	Shpenzime operative	Investime	Totali 2023
Bashkia Shkodër	P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (shtesë)				10,000,000	10,000,000
	P01110.Q2.O2.A18 Blerje automjete/vetura elektrike dhe biçikleta elektrike për administratën e Bashkisë Shkodër				15,000,000	15,000,000

	P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. (shtesë)	2,624,000	418,000			3,042,000
	P04520.Q1.O1.A1 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë)			1,512,000	35,604,000	37,116,000
	P04570.Q1.O1.A1 Lëvizshmëria dhe sinjalistika (shtesë)				12,720,000	12,720,000
	P06260.Q3.O1.A1 Shërbimi i Sistemit të Ndrëçimit Publik të Qytetit dhe Njësi Administrative (shtesë)			1,008,000	9,000,000	10,008,000
	P08220.Q1.O3.A14 "Ndërmendje" (shtesë)			700,000		700,000
	P08220.Q1.O3.A42 "100 vjetori i Simon Gjonit"			300,000		300,000
	P08220.Q1.O3.A43 "Festivali Muraleve Realizimi i muraleve"			800,000		800,000
	P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave"			2,000,000	1,500,000	3,500,000
Dega Ekonomike e Kulturës	P08220.Q1.O1.A1 "Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik (shtesë)			1,000,000		1,000,000
	P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë" (shtesë)			700,000		700,000
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	P09120.O3.A6 Ndërtim- shtesë e godinës për shkollën Ismet Sali Bruçaj, Guci e RE, Njesia Rethina (shtesë)				8,461,000	8,461,000
	TOTALI	2,624,000	418,000	8,020,000	92,285,000	103,347,000

KRYETAR

Benet Bllaci



Zv. Kryetar

Zv. Kryetar

Drejtoria e te Ardthurave

Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor

Arta Hexhaj

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes se investimeve të Infrastrukturës

Alfred Sulataj

Drejtoria e Ndihmes Ekonomike

Arta Gj

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

A. Peraj

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP

P. Allani Sekja

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Policia Bashkiake

Elton Hysaj

Drejtoria e Financës

D. Hysaj

Drejtoria e Administrimit te Sistemeve Menaxhimit te ZIN, Projekteve dhe Menaxhimit te Sistemeve te Informacionit

Enkel Progj

Drejtoria Juridike

D. Jorgjeva

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Arta Gj

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Gjergj Basha

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

Aida Sullaku

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit të Investimeve

Erjon Diberi

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Jasme Daj

Drejtoria e Turizmit

Për / Jorida Kyrti

Nr. 18	P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (shlyese)	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, përçështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi 01110: Planifikim Menaxhim dhe Administrim.
--------	---	---

Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Gjatë vitit 2022 është bërë një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative të saj, janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI, dhe një pjesë të konsiderueshme të këtyre pajisjeve i është kryer shërbimi i mirëmbajtjes.

Gjatë vitit 2022 janë blerë pajisje të reja TIK nga Bashkia ndërkohë që nevojat për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK janë tejet të nevojshme dhe gradualisht vjen e rritet nga viti në vit për shkak të amortizimit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licencuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI-t për Komunikimet Elektronik, asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standardeve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike. Gjithashtu faktor kryesor është plotësimi i shumë vendeve vakante që kërkojnë rritjen e numrit të pajisjeve TIK. Nevoja për blerje për një WorkStation për drejtorinë e Medias është imediate pasi pajisjet aktuale (aparati fotografik, dron, videokamera) prodhojnë material në cilësi shumë të larta dhe rezolucion me kapacitet të madh. Kompjuterat aktual të Drejtorisë së Medias nuk janë në gjendje optimale për të realizuar punën në cilësi dhe në kohë. Gjithashtu do të blihen disa printera pasi për shkak të volumit të punës shumë prej tyre kanë patur defekte të ndryshme. Duke parë gjendjen aktuale të kompjuterave në cdo zyrë, është e nevojshme patjetër rinovimi i tyre në një masë të konsiderueshme. Duhet gjithashtu pajisja me disa laptop për përdorim në aktivitete të ndryshme brënda dhe jashtë ambjenteve të Bashkisë. Duhet llogaritur gjithashtu rinovimi i disa kompjuterave në njësitë administrative.

ii. Synimi i projektit

Mbështetje e administratës vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Identifikimi i nevojës për pajisje TIK, llojit dhe sasisë së tyre, përgatitja e specifikimeve teknike të nevojshme bazuar në rregulloren e specifikimeve teknike dhe preventivimi brenda fondit limit të miratuar bazuar në testimin e tregut.

b) Rezultatet që prisni

Pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.

c) Aktorët e mundshëm

- Drejtoria e Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të Zyrës me Një Ndalesë, Projekteve dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit Ofruesi i Shërbimit (Service Provider) i cili do të ofrojë pajisjet.
- Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	10,000					10,000
	Shuma	10,000					10,000

	<p>P01110.Q2.O2.A18“Blerje automjete /vetura elektrike dhe bicikleta elektrike për administratën e Bashkisë Shkodër”</p>	<p>Funksioni I. Shërbime të përgjithshme publike. N/Funksioni 011. Organet ekzekutive dhe legjislative për çështjet financiare dhe fiskale , çështjet e brendshme. Programi 01110. Planifikim , Menaxhim dhe Administrim.</p>
<p>Përshkrimi i shkurtër i projektit: Aktualisht në funksion të administratës së bashkisë janë 7 automjete. Vetëm 3 janë automjete të reja të tjerat janë automjete të cilat kanë nevojë për shpenzime mirëmbajtje të konsiderueshme pothuaj cdo vit mbi 1.2 milion lekë shkojnë për mirëmbajtje. Pra të gjitha këto shpenzime përveç se nuk janë efektive, për shkak të vjetërsisë së tyre kanë një ndotje të madhe të mjedisit por edhe një konsum shumë të madh karburanti i cili përkethehet në shpenzime (lek) të mëdha por edhe në ndotje të madhe të ambientit me gazra. Për vetë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të administratës Bashkia kërkon të blejë 4 makina elektrike dhe disa dhjetra bicikleta elektrike.</p>		
<p>i. Situata Politikat e Qeverisë Shqiptare mbi angazhimin e saj për të qënë pjese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara ku edhe Shqipëria është nënshkruese e kësaj Konvente. Vetë Kushtetuta e jonë ka të përfshirë “ një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tashëm e të ardhshëm” . Nisur nga sa më sipër është një detyrim ligjor i bashkive në kuadër të ligjit Nr. 124/2015 “Për eficensën e energjisë” i ndryshuar , Ligjit nr 155/2020 “ Për ndryshimet klimatike” të marrin pjesë në mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi si detyrim ligjor edhe i funksioneve të saj , por nëpërmjet investimeve të saj të kursejnë energjinë detyrimisht zvogëlojnë emetimet e CO2 në ambient. VKM nr 872 dt 29.12.2021 “ Për miratimin e planit kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2030 “ parashikon edhe marrjen e masave nga të gjithë institucimet për zbatimin e tij. Nje nga Masa është edhe Eficienca e Energjisë në Transport / si edhe rritja e Përqindjes së Automjeteve në Flotën kombëtare të Transportit. Bashkia Shkodër në kuadër të projektit “ bashki me Shfrytëzim inteligjent energjie” në bashkëpunim me specialistët zviceranë është duke hartuar “ Planin Lokal për Energji dhe Klimë”, plan i cili brenda muajit tetor do të vijë pranë këshillit të Bashkisë për shqyrtim. Ky plan një nga objektivat kryesore për zbatim ka edhe Eficiencën e energjisë në fushën e transportit në përgjithësi dhe atij publik/bashkiak në vecanti. Për të përmbushur këto objektiva që janë pjesë e Politikës së bashkisë në fushën e transportit / mbrojtjes së mjedisit dhe eficiencës së energjisë parashikon blerjen e 4 automjeteve elektrike për administratën e bashkisë si edhe blerjen e disa bicikletave elektrike , po për këtë administratë.</p>		
<p>ii. Synimi i projektit -Reduktimi i kostove të mirëmbajtjes së automjeteve. -Reduktimi i kostove për shpenzime karburanti. -Reduktimi i konsumit të energjisë fosile dhe garantim i qëndrueshmërisë së transportit publik, përmes automjeteve elektrike - Përmbushja e angazhimeve të bashkisë në kuadër edhe të Planit Lokal për Energji dhe Klimë i cili është në fazën përfundimtarë të realizimit . - Reduktimi i ndotjes së ajrit me anë të promovimit të makinave elektrike, sipas standardeve evropiane - Pritet ndikimit i pritshëm në transport të zvogelimit të shkarkimeve të CO2, në qytet.</p>		
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit - Ngritja e disa stacionesh karikimi elektrik në të gjithë qytetin .Aktualisht pranë bashkisë funksionon nje karritues , dhe shume shpejt planifikohet nje karritues tjeter i cili do te karrikohet me panele fotovoltaike. - Blerja e automjeteve dhe bicikletave elektrike - përdorimi i tyre</p>		
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</p>		

- Reduktimi i kostove të mirëmbajtjes së automjeteve.
- Reduktimi i kostove për shpenzime karburanti.
- Reduktimi i konsumit të energjisë fosile dhe garantim i qëndrueshmërisë së transportit publik, përmes automjeteve elektrike
- Përbushja e angazhimeve të bashkisë në kuadër edhe të Planit Lokal për Energji dhe Klimë i cili është në fazën përfundimtarë të realizimit .
- Reduktimi i ndotjes së ajrit me anë të promovimit të makinave elektrike, sipas standardeve evropiane
- Pritet ndikimit i pritshëm në transport të zvogelimit të shkarkimeve të CO2, në qytet.

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
Bashkia Shkodër Agjencia për Eficencën e Energjisë Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO)	Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mij e lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sig u rim e	Operati v e	Trans f erime
A. 1	Blerje automjete/vetura elektrike dhe bicikleta elektrike për administratën e bashkisë shkodër	15.000				15.000
	Shuma	15.000				15 000

f) Periudha e zbatimit. (kur fillon , kur perfundon) 2023	g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve mbeshtetese. Institucion Likuidues: Bashkia Shkoder
---	--

<p>Nr. 1</p>	<p>P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësie të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. (Shtese)</p>	<p>Funksioni 3: Rendi dhe siguria publike N/Funksioni 031: Shërbimet policore Programi 03140: Shërbimet e Policisë Vendore</p>
<p>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>		
<p>i. Situata</p>		
<p>Policia Bashkiake Shkodër ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 2003 me një efektiv prej 17 punonjësish, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 313 datë 01.07.2002, numër që i është përgjigjur detyrimeve ligjore dhe numrit të banorëve të bashkisë të asaj kohe.</p> <p>Në gusht të vitit 2015, pas Reformës Territoriale(marja në administrim i ish komunave), numri i popullsisë në Bashkinë Shkodër është rreth 204.954 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114.085 banorë) ndërsa pjesa tjetër përkëtohet njësive administrative që tashmë janë pjesë e Bashkisë Shkodër.</p> <p>Mund të themi se para zbatimit të kësaj reforme territoriale, ish-komunat që aktualisht janë bashkuar Bashkisë Shkodër kanë patur në strukturën e tyre numër të konsiderueshëm punonjësish policie komune/bashkie, të cilët pas reformës territoriale nuk janë bashkuar strukturës së Policisë Bashkiake Shkodër.</p> <p>Aktualisht numri i punonjësve të Policisë Bashkiake Shkodër është 24.</p> <p>Mund të themi se me ndryshimet ligjore në vite dhe së fundi me ligjin e ri të Policisë Bashkiake detyrat janë dyfishuar. Shkodra si një qytet me potencial të madh turistik, me fluks vizitorësh, ku në pikun e sezonit turistik ka një fluks real deri në rreth 200.000 vizitorë/pushues, njëkohësisht dhe me shtimin e numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet gjatë sezonit turistik në tërë zonat turistike të Velipojës dhe Thethit shluan me ndarjen e re administrative të vitit 2015, e për pasojë edhe të problematikave të ndodjes së ambjentit, ndotjes akustike, zënien e shfrytëzimitin e hapësirave publike, qarkullimitin rrugorë, ç'ka kërkon një angazhim më të madh të forcave dhe mjeteve.</p> <p>Nisur nga më sipër, me qëllim rritjen në një shkallë më të lartë të shërbimeve të Policisë Bashkiake ndaj dhe në shërbim të komunitetit, për realizimin me sukses të detyrave të saj funksionale, mendojmë se duhet të shtohet numri i punonjësve të Policisë Bashkiake me 10 punonjës , gjë e cila vjen si domosdoshmëri. Shkurtimisht mund të rendisim disa nga shkaqet për këto gjë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritjes së numrit të popullsisë së qytetit të Shkodrës, plus njësitë administrative që pas ndarjes së re territoriale janë pjesë e Bashkisë Shkodër. • Shtimit të numrit të automjeteve në qarkullim në mënyrë progresive dhe për pasojë janë shtuar edhe kundravajtjet administrative, nevoja për rritjen dhe forcimin e masave të sigurisë rrugore. • Zgjerimit të sipërfaqes së territorit e cila duhet të mbulohet me shërbime të Policisë Bashkiake. • Rritjes së numrit të subjekteve juridik dhe fizik, ndaj të cilave duhet të ushrohet kontroll i vazhdueshëm për zbatimin e ligjshmërisë. • Rritje e evidentimit të rasteve të zënies së hapësirave publike dhe shfrytëzimit të tyre në mënyrë të paligjshme. • Kërkesës së vazhdueshme për mbështetje e bashkëpunim nga strukturat e ndryshme të Bashkisë Shkodër, si Drejtorisë së të Ardhurave, I.M.T., U.K., A.K.U. Emergjencave Civile në rastet e fatkeqësive natyrore, etj. • Kërkesave të vazhdueshme për të mundësuar konstatimin, parandalimin dhe pezullimin e ndërtimeve pa leje dhe dërgim informacioni IMT-së, për procedurë të mëtejshme. • Rritjes së numrit të kundravajtjeve për ndotjen e mjedisit, zënien e hapësirave publike, prishje të qetësisë publike etj. • Rritjes së numrit të gjobave të vendosura në raport me vitet më përpara, vjelja e tyre dhe për pasojë rritja e të ardhurave. • Numrit të madh të aktiviteteve që organizohen nga/ose me lejen e Bashkisë Shkodër, ku në vazhdimësi kërkohet mbështetja e Partisë Bashkiake. • Rritjes së numrit të ankesave të ardhura nga qytetarë apo institucione me shkresa, e-mail etj. • Të nevojës për mbështetje dhe bashkëpunim me firma të ndryshme që kryejnë punë publike në territorin e Bashkisë Shkodër. 		
<p>Rritjes së distancës nga qendra e Bashkisë Shkodër deri në pikat ekstreme territorit të njësive administrative.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Paga dhe shtesat mbi paga 		
<p>Policia bashkiake ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 89,datë 22.12.2022 "Për Policine Bashkiake".</p> <p>Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016"Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" llogaritet buxheti për shpenzime personeli i cili bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar.</p> <p>Struktura e policisë bashkiake përfshin, 34 punonjës policë bashkiake. Të gjithë punonjësit e policisë kanë realizuar trajnimet përkatëse konform dispozitave ligjore. të ofruara nga akademia e policisë Tiranë.</p> <p>- Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</p> <p>Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, date 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, date 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".</p>		

- **Kompensim për kryefamiljarët me ngarkesë me më shumë se tre persona në ngarkim**
Sipas VKM Nr. 499, dt 13.08.1998, VKM. Nr. 683 dt 28.10.1988 dhe udhëzimit të M.P.Ç.Sociale, nr 3311, dt 24. 12.1998, të punësuarit në sektorin buxhetor përfitojnë shpërblim sipas rastit.

ii. Synimi i projektit

Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të Policisë Bashkiake

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Sigurimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për Policinë Bashkiake.

b) Rezultatet që prisni

Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të Policisë Bashkiake në mbështetje të përbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë.

c)Aktorët e mundshëm

1. Policia Bashkiake
2. Drejtoria e Financës
3. Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër

d)Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia e Shkodrës

e)Shpenzime të llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Paga dhe shtesat mbi paga	2,624	2.624				
A.2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	418		418			
	Shuma	3,042	2.624	418			

f)Periudha e zbatimit

Gjatë vitit 2023,

g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Policia Bashkiake

Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër

Nr. 1	P04520.Q1.O1.A1 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtese)	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 045: Transporti Llojet e programit: 04520: Rrjeti rrugor rural
-------	---	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015, datë 17. 12. 2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", pika 4: Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Gjatësia totale e rrjetit rrugor që mirëmbahet në qytet është 202.3 km.

LAGJET QYTET	Gjatësi rruge (m)	Sipërfaqe rruge (m ²)	Sipërfaqe Sheshe (m ²)	Rrug të asfaltuara (m ²)	Rrugë të pa asfaltuara (m ²)	Rrugë me shtresë dekorative (m ²)	Rrugë pjesërisht të asfaltuar (m ²)
LAGJJA 1	80,139	298,121	16,009	192,873	94,473	1,122	9,653
LAGJJA 2	34,033	181,540	7,782	144,156	33,420	-	3,964
LAGJJA 3	24,133	109,389	2,284	72,820	29,941	6,628	-
LAGJJA 4	32,669	120,654	9,692	76,327	27,992	6,675	9,660
LAGJJA 5	31,362	127,277	1,471	78,825	48,452	-	-
TOTALI	202,336	836,981	37,238	565,001	234,278	14,425	23,277

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në qytet realizohet me sipërmarrje private. Llogaritja e fondit limit për punimet e shërbimit bëhet konform modeleve dhe rregullave të përshkruara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 8.5.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe Vendimit Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Preventivi i punimeve konsiston në kryerjen e punimeve:

- Preje dhe skarifikim të asfaltit ekzistues;
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne themele gjeresi, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke;
- Punime shtresash (Stabilizant dhe Çakull);
- Punime shtresash asfaltike (Binder dhe Asfaltobeton);
- Prishje struktura prej betoni;
- Punime betoni (C12/15&C16/20) dhe hekuri;
- F.V Bordura betoni 15x25 cm dhe 15x30 cm;
- Punime për KUB & KUZ (F.V Tuba HDPE Ø250, Ø315 mm dhe Puseta shiu 40x60, h=1m me kapak gize, etj);
- Punime për riparimin e trotuareve me pllaka granili;
- Punime për riparimin e pllakave të gurit;

volumi i përgjithshëm i punimeve të kryera në vitin 2022 është:

1. Riparim shtresash afaltike: 4271 m² tapet dhe 1446m² binder
2. Riparim trotuari me pllake granili 313m²;
3. Riparim i gurëve të dëmtuar 383 m²;
4. Ndërtim panduse trotuari 5 cope.

Problematika që paraqiten

- Nga një vlerësim teknik i bërë në të gjithë rrugët, rrugicat dhe hapësirat publike në qytet, rezulton se rrjeti rrugor në qytet është shumë i amortizuar dhe numri i ndërhyrjeve të paparashikuara dhe volumi i punimeve të mirëmbajtjes është shumë me i madh se fondet e parashikuara.
- Rrjeti rrugor në qytet ka shembje, gropa, çarje të ndryshme si dhe dëmtime nga ndërhyrje të paligjshme apo vjedhje. Ndërhyrjet e vazhdueshme në infrastrukturë për riparimin e rrjeteve nëntokësore të amortizuar dhe punimet me cilësi të dobët nga sipërmarrjet private përshpejtojnë amortizimin në këto rrugë. Po kështu ka disa dëmtime edhe në trotuare. Nga amortizimi apo edhe dëmtimi pllakat lëvizin ose janë thyer. Shpesh verifikohen veprime të papërgjegjshme nga banorët dhe bizneset.

Institucioni i Bashkisë Shkodër pas reformës territoriale, ka ndjekur dhe respektuar procedurën ligjore për verifikimin dhe mbledhjen e të dhënave për të gjithë inventarët. Vërehet se ka mangësi në bazën e të dhënave që përcakton saktë sipas një vlerësimi shkencor rrugët, gjendjen e tyre, nivelin e amortizimit dhe shpesh mungojnë edhe të dhënat bazë për sipërfaqen dhe gjatësinën e tyre. Për

këtë do të nevojitet që specialistët pranë drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastruktura dhe drejtorisë së Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve të hartojnë dhe të zbatojnë planin e punës për të hartuar bazën e saktë të të dhënave.

ii. Synimi i projektit

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve sipas prioriteteve:

- Ndërhyrje emergjente
- Ndërhyrje për përmirësim sipas një kalendari të miratuar

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Blerje automjete

- Kamionçine 5 vendesh, veteshkarkus, 3-5 ton (3 copë)
- Kamionçine, veteshkarkus, 3-5 ton (2 copë)
- Kamionçine, 2.5 ton (1 copë)
- Kamion veteshkarkus 8 m3 (1 copë)
- Kamion veteshkarkues me vinç 10 ton (1 copë)
- Fadrome (1 copë)
- Eskavator me goma me krah te gjate, tip Benati (1 copë)
- Asfalto shtruese, me hapje 2-5 m (1 copë)
- Rrul i vogel deri ne 2 ton (1 copë)
- Mjet zhbllokues per kanalet (1 copë)

Blerje mjete pune

- Rrul dore me motor me benzine (1 copë)
- Moto-betonier 0.25 m3 (1 copë)
- Tokmak dore me motor (1 copë)
- Matrapik i madh (3 copë)
- Çistemo uji 5 m3 (1 copë)
- Pistolete lavazhi per larje puseta ruge (1 copë)

Blerje veshje punetoresh

- Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet veror (60 copë)
- Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet dimeror (60 copë)

b) Rezultatet që prisni

- Shpejtësi në ofrimin e shërbimit.
- Rritje e efijences në ofrimin e shërbimit.
- Rritje kapaciteti për përballimin e rritjes së infrastrukturës urbane.
- Siguri me e lartë në ofrimin e shërbimit.
- Rritje e konfortit në punë për punëtorët e shërbimit.
- Rritje e sigurisë në punë

c) Aktorët e mundshëm

Drejtoria e Shërbimeve publike dhe ndjektes së investimeve të infrastrukturës
Banorët e qytetit dhe njësisve administrative,
Qytetarët;
Bizneset;

d) Kontributet e mundshme në projekt

Buxheti i Bashkisë

e) Shpenzimet e llogaritura

Drejtoria e Shërbimeve publike dhe Infrastruktura publike sipas nevojës së verifikuar dhe prioritetit do të bëjë detajimin e planit sipas zërave të mësipërm dhe do të monitorojë realizimin e kryerjes së shërbimit.

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Kapitale
A.2.1	Blerje automjete	33,840				33,840
	<ul style="list-style-type: none"> • Kamionçine 5 vendesh, veteshkarkus, 3-5 ton (3 copë) • Kamionçine, veteshkarkus, 3-5 ton (2 copë) • Kamionçine, 2.5 ton (1 copë) • Kamion veteshkarkus 8 m3 (1 copë) • Kamion veteshkarkues me vinç 10 ton (1 copë) 					

	<ul style="list-style-type: none"> • Fadrome (1 copë) • Eskavator me goma me krah te gjate, tip Benati (1 copë) • Asfalto shtruese, me hapje 2-5 m (1 copë) • Rrul i vogel deri ne 2 ton (1 copë) • Mjet zhblokues per kanalet (1 copë) 					
A.2.2	Blerje mjete pune <ul style="list-style-type: none"> • Rrul dore me motorr me benzine (1 copë) • Moto-betonier 0.25 m3 (1 copë) • Tokmak dore me motorr (1 copë) • Matrapik i madh (3 copë) • Çisterno uji 5 m3 (1 copë) • Pistolete lavazhi per larje puseta ruge (1 copë) 	1,764				1,764
A.2.3	Blerje veshje punetoresh <ul style="list-style-type: none"> • Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet veror (60 copë) • Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet dimeror (60 copë) 	1,512			1,512	
	Shuma 2023	37,116			1,512	35,604
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 1	P04570.Q1.O1.A1: Lëvizshmëria dhe sinjalistika (shtese)	Funksioni 4: Çështje ekonomike N/Funksioni 045: Transporti Llojet e programit: 04570: Transporti publik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
a. Lëvizshmëria		
Është realizuar shërbimi për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale: Është kryer vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore.		
<ul style="list-style-type: none"> • Janë ndërtuar 13 rampa për lehtësimin e lëvizjes së personave me aftësi ndryshe. Ndërtimi i tyre është bërë në kryqëzimet dhe rrugët kryesore të qytetit. • Është realizuar mirëmbajtja e sinjalistikës vertikale dhe është bërë plotësimi sipas nevojave në zbatim të vendimeve të marra duke bashkëpunuar dhe me Drejtorinë e Policisë së Qarkut sektorin e qarkullimit rrugor. • Shërbimi i sinjalistikës është realizuar edhe në njësitë e tjera administrative kryesisht në Nj.A Velipojë, para fillimit të sezonit të plazhit por edhe në zonat e banuara të njësisve administrative Rrethina, Guri Zi, Bërdicë, Postrinë dhe Ana e Malit. • Është bërë plotësimi me sinjalistikë horizontale e vertikale, në të gjitha rrugët e rikonstruara me financimet e Bashkisë Shkodër si pjesë e projekteve të zbatimit. 		
Situata e vlerësuar:		
<ul style="list-style-type: none"> - Trafik i ngarkuar si rezultat i qarkullimit të automjeteve në akset kryesore dhe në qendër të qytetit, - Nevoja për plotësim me sinjalistikë për kufizim shpejtësie për rritjen e sigurisë rrugore, në pika të caktuara. - Krijimi i kushteve të lëvizjes për përdoruesin e mjeteve me aftësi të kufizuara nëpërmjet vazhdimit të ndërtimit të rrampave dhe plotësim, mirëmbajtjen sinjalistikës për të krijuar kushtet e lëvizjes për këto kategori. - Nevoja për përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen me biçikleta si dhe promovimi i pedalimit. - Nevoja për riparim i bumpeve të gomës të realizuar në vitet e mëparshme - Përdorimi i mjeteve të transportit publik nuk ka qenë në nivelin optimal, e cila do të sjellte ulje e përdorimit të automjeteve personale. - Dëmtime të qëllimshme të sinjalistikës, si dhe nga aksidentet rrugore. - Përmirësimi i sinjalistikës në njësitë e reja administrative ku ka mungesë të theksuar të sinjalistikës horizontale e vertikale. 		
ii. Synimi i projektit		
Rritja e kapaciteteve logjistike për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit. Efiçencë në ofrimin e shërbimit.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Blerje automjete		
<ul style="list-style-type: none"> • Forstradë me karroceri (Pickup) (2 copë) 		
Për lëvizjen e punjesve në territorin e Bashkisë Shkodër, si dhe transportin e paisjeve dhe veglave të punës		
<ul style="list-style-type: none"> • Makine vijëzimi (1 copë) 		
Për zgjerimin e shërbimit në qytet dhe njësi administrative		
Blerje mjete pune		
<ul style="list-style-type: none"> • Prerese asfalti me motor me benzine (1 copë) • Matrapik i vogël (2 copë) • Saldatriçe me gjenerator (2 copë) • Saldatriçe (2 copë) • Moto-gjenerator (1 copë) 		
Për zgjerimin e kapaciteteve teknike për realizimin e shërbimeve		
b) Rezultatet që prisni		

- Shpejtësi në ofrimin e shërbimit.
- Rritje e efikasitetit në ofrimin e shërbimit.
- Rritje kapaciteti për përballimin e rritjes së infrastrukturës urbane.
- Siguri me e lartë në ofrimin e shërbimit.
- Rritje e konfortit në punë për punëtorët e sinjalistikës.

c) Aktorët e mundshëm

d) Kontributet e mundshme në projekt

Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës
Drejtoria e Financës.

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Kapitale
A.4.1	Blerje automjete <ul style="list-style-type: none"> • Forstradë me karroceri (Pickup) (2 copë) • Makine vijezi (1 copë) 	9,600				9,600
A.4.2	Blerje mjete pune <ul style="list-style-type: none"> • Prerese asfalti me motorr me benzine (1 copë) • Matrapik i vogel (2 copë) • Saldatriçe me gjenerator (2 copë) • Saldatriçe (2 copë) • Moto-gjenerator (1 copë) 	3,120				3,120
Shuma 2023		12,720				12,720
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës; Njësia e Prokurimit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 1	P06260.Q3.O1.A1: Shërbimi i Sistemit të Ndrëçimit Publik të Qytetit dhe Njërive Administrative (shtese)	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet publike vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Shërbimi i ndriçimit publik të qytetit në Qytet, përfshin mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ndriçimit në qytet dhe në njësi administrative, të klasifikuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndriçimi i rrugëve kryesore dhe dytësore • ndriçimi i shesheve • ndriçimi i parqeve dhe lulishteve <p>Sipërfaqja totale e rrugëve dhe e shesheve, arrin afërsisht 1,600,000 m², nga të cilat 1,395,900 m² janë të ndriçuara, ose 83.1% e sipërfaqes totale, të rrugëve dhe shesheve.</p> <p>Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbër në qytet zënë një hapësirë mbi 66,000 m², nga të cilat 42,000 m² janë të ndriçuara, ose 63.6% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar.</p> <p>Ndriçimi realizohet në një mesatare vjetore 10.5 orë në ditë gjatë gjithë vitit.</p> <p>Asetet në dispozicion të shërbimit të ndriçimit publik për qytetin janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i pikave të furnizimit të energjisë (kabinave elektrike) që kanë kontratë 302kontrata • Numri i ndriçuesve të instaluar 5290 copë <p>Në territorin urban të qytetit ka 3 lloje shtyllash:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dekorative: të cilat gjenden në zonat pedonale dhe disa nga parqet e qytetit; • çeliku: pothuajse të gjitha të zinkuara, përbëjnë pjesën dominuese të shtyllave që shërbejnë për ndriçimin e qytetit; • betoni: shtyllat i përkasin OSHEE, por ndriçuesit janë të Bashkisë Shkodër. <p>Nëpërmjet shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit realizohet puna për rehabilitimin rrjetit elektrik ekzistues në rrugë kryesore, dytësore në të gjithë Bashkinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mirëmbajtje e 5,290 ndriçuesve të zakonshëm; • Mirëmbajtje e 148 ndriçuesve dekorativ; • Realizimi i pagesës për konsumin e energjisë elektrike për të gjitha kontratat në qytet dhe njësitë administrative. • Realizohen investime të reja. <p>Shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Numri i punonjësve të sektorit është 9 (nëntë).</p> <p>Mirëmbajtja realizohet me të ardhurat e Bashkisë, që mbulojnë: shpenzimet për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të cilat planifikohen çdo vit, në bazë të preventivave dhe miratohen në buxhetin e Bashkisë.</p> <p>Në njësitë e tjera administrative situata e ndriçimit është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nj.A. Rrethina: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Shtoj i Ri me 19 ndriçues, Rruga Guci e Re me 16 ndriçues, fshatit Grudë me 9 ndriçues, fshati Bardhaj degëzim me 7 ndriçues, Dobraq me 34 ndriçues, Grudë të Re me 12 ndriçues, Lagjja Vinotekë me 8 ndriçues, në fshatin Bardhaj me 15 ndriçues, Hot i Ri me 10 ndriçues, Grudë me 5 ndriçues, Bardhaj me 4 ndriçues. • Nj.A. Bërdicë: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Mllojë me 12 ndriçues, Rruga e Beltojës me 7 ndriçues, Trush me 25 ndriçues, në Bërdicë e Sipërme me 23 ndriçues dhe në GjoMarkaj me 15 ndriçues, Masmalaj me 17 ndriçues. • Nj.A. Gur i Zi: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga Shkodër- Mjedë me 12 ndriçues, rruga Gajtan me 8 ndriçues, Fshatit Ganjollë me 10 ndriçues, Vukatanë me 35 ndriçues, Juban me 12 ndriçues, Kuç me 12 ndriçues, Qendra e Rrencit me 22 ndriçues dhe Rragam me 10 ndriçues. • Nj.A. Postrinë: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga e Madhe me 25 ndriçues, rruga Rosek me 10 ndriçues, fshati Drisht me 6 ndriçues, fshati Myselim me 5 ndriçues, fshati Boks me 19 ndriçues, fshati Dragoç me 14 ndriçues, fshati Kullaj me 6 ndriçues, dhe fshati Mes me 6 ndriçues. • Nj.A. Dajç: Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: Rruga e Emigrantëve me 18 ndriçues, kryqëzimi i Dajçit me 13 ndriçues, fshati Pentar me 7 ndriçues, Qendra e Dajçit me 25 ndriçues, Samrish të Ri me 5 ndriçues, Samrish i Vjetër me 18 ndriçues, Mushan me 20 ndriçues dhe Darragat me 17 ndriçues. • Nj.A. Velipojë: Është realizuar mirembajtja e ndriçimit të lulishtes në qendër të Velipojës me ndriçues LED në një sipërfaqe 		

prej 17 000 m2. Është mbajtur në efikasitet të plotë ndriçimi i shëtitores së Velipojës. Gjithashtu janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: rruga nr.7 me 9 ndriçues, rruga nr.12 me 12 ndriçues, rruga nr.13 me 6 ndriçues, rruga nr. 2 me 11 ndriçues, rruga nr. 3 me 8 ndriçues, plazhi Velipojë me 37 ndriçues, rruga hyrëse- lulishte qendër me 31 ndriçues, si dhe rruga nga Qendra deri në Hidrovor me 15 ndriçues.

- **Nj.A. Ana e Malit:** Janë mirëmbajtur dhe janë në efikasitet linjat: rruga Muriqan- Qendër me 7 ndriçues, rruga Goricë me 3 ndriçues, rruga Obot me 8 ndriçues, rruga Veliaj Alimetaj me 8 ndriçues dhe rruga Oblikë (bloku i pallateve) me 6 ndriçues

Është realizuar investimi për Rehabilitim i ndricimit të lulishtes Plazh- Velipojë. Ndricimi është realizuar me shtylla ndricimi LED të teknologjisë së fundit që do të kenë kursim në raport me ndricuesit e vjetër SMART SON. Janë vendosur 98 shtylla nga 67 të mëparshmet.

Gjate vitit 2022 Bashkia Shkodër nëpërmjet projektit SEMP (Bashki te Zgjuara Energjie) ka hartuar projektet teknike për instalimin e ndricuesve me efikasitet energjie të teknologjisë LED.

Janë projektuar 11 rrugët kryesore të qytetit të Shkodrës, të cilët do të krijojnë mundësinë e ndricimit me të mirë të rrugëve me një kosto me të ulët. Projekti parashikon zëvendësimin e rreth 500 ndricuesve të teknologjisë së vjetër SAP SON me fuqi 250 W me ndricues LED me fuqi 80 W. Ky investim fillon zbatimin në vitin 2023.

Problemet e paraqitura

- Dëmtimi i ndricuesve, i shtyllave zinkat dhe kapakëve. Nga aksidentet rrugore dhe amortizimi i ndricuesve janë dëmtuar dhe kanë dalë jashtë funksioni shtylla zinkat 8 - 10 m dhe ndricues SMART, dhe vjellja e kapakëve
- Mosfunksionimi i linjave të ndricimit të Unazës Lindore dhe segmentin Ura e Bardhajve- Qendër Mes të cilat megjithëse kanë përfunduar si investim, nuk janë dorëzuar pranë Bashkisë Shkodër në administrim dhe mirëmbajtje.
- Nevoja për reduktimin e shpenzimeve të energjisë elektrike nëpërmjet instalimit të ndricuesve me efikasitet energjie të teknologjisë LED.

Monitorimi:

Monitorimi i shërbimit realizohet nëpërmjet Drejtorisë dhe Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës. Evidentimi i defekteve dhe raportimi i tyre pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës bëhet nga njësitë administrative dhe punonjësit e ndricimit publik sipas njësive që ata mbulojnë. Gjithashtu formë tjetër është informimi nga komuniteti nëpërmjet shkrësive apo njoftimeve të ndryshme pranë zyrave të informimit për publikun në çdo Njësi Administrative.

I. Shpenzimet për pagesat e ndricimit rrugor për qytetin dhe njësitë administrative

Për sektorin e ndricimit rrugor janë aktualisht 302 kontrata aktive me rreth 5,290 ndriçues në qytet dhe 51 kontrata në njësitë e reja administrative. Në fillim të vitit në buxhet parashikohen shuma për pagesën e energjisë elektrike në bazë të fuqisë së instaluar. OSHEE faturon çdo muaj 302 kontratat e furnizimit me energji. Për çdo problem në lidhje me faturimin bëhet verifikimi në terren. Për leximin, për problemet që kontestohen, mbahet proces- verbali përkatës dhe pastaj ndiqet në rrugë administrative dhe gjyqësore. Një herë në vit bëhet akt- rakordimi me OSHEE për të gjitha kontratat e ndricimit rrugor. Plani i parashikuar për vitin 2022 për pagesën e energjisë së ndricimit rrugor ka qënë 84,657,000 Lekë, që përbën:

Pagesat për konsumin e parashikuar sipas fuqisë së instaluar

Detyrime të prapambetura principal dhe kamata sipas akt-rakordimit me FSHU për fatura të papaguara nga mbifaturimi i OSHEE. Këto fatura nuk janë paguar pasi nuk është vlera e konsumit nuk ka aritur leximin faktik të matësve.

Problemet e paraqitura

- Faturimet e parregullta ku shpesh paraqiten probleme me mbifaturime, lexim jashtë kushteve teknike

ii. Synimi i projektit

Rritja e kapaciteteve logjistike për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimit. Efikasitet në ofrimin e shërbimit.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Blerje automjete

- Kamion me vinc me kosh (1 cope)
- Foristrade me karroceri (Pickup) (2 cope)
-

Duke marrë shkas nga zgjerimi i rrjetit në qytetin e Shkodrës dhe njësive administrative të Bashkisë Shkodër, dhe sidomos rritja eksponenciale e sasisë së ndricuesve në këto të fundit, për garantim sa më të mirë të ofrimit të shërbimit të ndricimit lind nevoja e rritjes së flotës së automjeteve. Këto automjete do të risin efikasitetin e ofrimit të këtij shërbimi duke rritur shpejtësinë e riparimit të defekteve, përdorimin e mjeteve me tonazh më të vogël për defekte më të shpërndara, si dhe zëvendësimin e mjeteve ekzistuese të amortizuara që realizojnë këtë shërbim.

Blerje veshje punetore

- Veshje punetore që punojnë jashtë, komplet veror (40 cope)

<ul style="list-style-type: none"> Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet dimeror (40 cope) <p>Përdorimin i veshjeve të diferencuara dhe të personalizuar për çdo punonjes që ofron shërbimin e ndriçimit. Kjo do të rrisi sigurinë në punë si dhe konfortin e personelit që do realizojë punimet.</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Shpejtësi në ofrimin e shërbimit. Rritje e efijences në ofrimin e shërbimit. Rritje kapaciteti për përballimin e rritjes së sistemit të ndriçimit. Siguri me e lartë në ofrimin e shërbimit. Rritje e konfortit në punë për punëtorët e ndriçimit Rritje e sigurisë në punë 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Punonjësit e sektorit të ndriçimit Banorët e qytetit dhe njësisve administrative; Qytetarët; Bizneset;			Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	
A.1.9	Blerje automjete <ul style="list-style-type: none"> Kamion me vinc me kosh (1 cope) Forstrade me karroceri (Pickup) (2 cope) 	9,000				9,000
A.1.10	Blerje veshje punetoresh <ul style="list-style-type: none"> Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet veror (40 cope) Veshje punetoresh qe punojne jashte, komplet dimeror (40 cope) 	1,008			1,008	
	Shuma 2023	10,008			1,008	9,000
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria Shërbimeve Publike, ndjekjes së investimeve të Infrastrukturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.1	P08220.Q1.O1.A1 "Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit" Ekspozitë me karakter historik dhe artistik (shkese)	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.	
i. Situata			
<p>Çdo vit, në vazhdim të përkujtimit të festave të nëntorit, Muzeu Historik Shkodër organizon aktivitete, duke iu bashkëngjitur eventeve të kthyera tashmë në traditë. Java e Pavarësisë dhe e Çlirimit organizohet nga Bashkia e Shkodrës me përfshirjen e institucioneve të kulturës, organizata e qytetarë.</p> <p>Per vitin 2023 po planifikojme nje ekspozite me arme te luftes se pare Boterore e ne vazhdim ,arme te cilat jane pjese e fondit te arkivit te Muzeut Historik Shkoder.</p> <p>Drejtorja e Kulturës, me qëllim promovimin e këtij aktiviteti do realizohet një video promovuese Shkodër – Kosovë dhe realizimi koncertit të Orkestrës Sinfonike me këngë qytetare shkodrane.</p>			
ii. Synimi i projektit			
<ul style="list-style-type: none"> • Evidentimi i vlerave dhe fakteve historike, kulturore e të trashigimisë në periudhën e Pavarësisë, 28 nëntor 1912. • Njohja e publikut, kryesisht e të rinjve, me këto fakte historike e dëshmi, përmes ekspozimit artistik në muze. 			
iii. Aktivitetet kryesore të projektit			
<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedhja e materialeve që do ekspozohen; • Kurimi i fondit të objekteve në funksion të ekspozimit; • Përgatitja e materialeve promovionale për aktivitetin; • Video promovuese • Koncert i Orkestrës Sinfonike 			
b) Rezultatet që prisni			
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe përcjellja e historisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike; • Nxitja e studimeve ndaj këtyre çështjeve në ditët e sobme; • Rikthimi i vëmendjes së publikut tek këto elemente të veçantë të trashëgimisë kulturore. 			
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Muzeut; • Vizitorët; • Studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi"; • Studiues dhe bashkëpunëtorë të Muzeut; 	Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm		
e) Shpenzimet e llogaritura			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali (mijë lekë)	Nga kjo: Paga Sigurime Operative Transfer Kapital	
a.2	Video promovuese	1000	1000
Shuma		1000	1000
f) Periudha e zbatimit Janar-Dhjetor 2023	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Drejtorja Ekonomike e Kulturës		

Nr. 19	P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare "Luleborë" (shtese)	Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Qyteti i Shkodrës njihet për bukurinë e këngës qytetare dhe përcjelljen e saj ndër breza. Bashkia Shkodër, në kuadër të rikthimit të traditës të krijimit të këngës qytetare me motive shkodrane ka kthyer tashmë në traditë organizimin e përvitshëm të Festivalit të Këngës Qytetare "Luleborë". Ai ka treguar që ka një impakt pozitiv tek qytetarët, duke patur parasysh edhe lidhjen shpirtërore me këtë lloj zhanri muzikor.						
Nisma për organizimin e këtij Festivali synon ruajtjen e vlerave të muzikës qytetare dhe pasurimin e saj me repertor të ri. Festivali "Luleborë", ka si qëllim t'i japë një dimension të ri këngës qytetare, duke ruajtur vazhdimësinë e një tradite të hershme dhe me shumë vlerë për qytetin e Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë.						
Duke parë forcat krijuese dhe interesimin e madh qytetar për këtë Festival, ai është në vendin që i takon, në Shkodër, Festivali "Luleborë" ka gjithëpërfshirje të krijuesve në muzikë, tekste, orkestrome dhe interpretim. Krijimtaria dhe interpretimi do të vlerësohen nga një juri e përbërë nga personalitete të fushës së artit.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e këngës qytetare shkodrane dhe pasurimi me këngë të reja. • Edukimi dhe afirmimi i artistëve, kryesisht i brezit të ri, të cilët e duan dhe e promovojnë këngën qytetare shkodrane dhe shqiptare. • Nxitja e turizmit kulturor. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e grupit realizues. • Kontakti me krijuesit, përzgjedhja e këngëve, këngëtarëve dhe instrumentistëve. • Prova intensive me orkestrën dhe këngëtarët. • Sigurimi i ambjenteve, fonisë, ndriçimit dhe e gjithë bazës materiale. • Përgatitja e materialeve promociionale dhe reklamimi cilësor në media. • Realizimi i dekorit të ambjenteve. • Bashkërendimi i punëve me stafin realizues. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e interesit për të gjithë komunitetin artistik dhe artdashës, për ruajtjen dhe pasurimin me repertor të ri të kësaj trashëgimie, e cila na dallon nga kulturat e komuniteteve të tjera. • Rritja e nivelit artistik të krijimit dhe të interpretimit. • Gjallërimi i mëtejshëm i jetës artistike në qytet dhe më gjerë. 						
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshmenëprojekt					
<ul style="list-style-type: none"> • Komuniteti artistik dhe artdashës 	Bashkia Shkodër. Teatri "Migjeni". Të ardhurat nga biletat. Donatorë të mundshëm.					
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.5	Honorare, Instrumentist, 28 persona x 25,000 lekë	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma	700		700		
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2023	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Institucioni Likuidues: Dega Ekonomike e Kultures					

Nr.25	P08220.Q1.O3.A14 "Ndërmendje" (shitese)	Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Koncerti i fundvitit, i kthyer tashmë në traditë, është një aktivitet me baza të konsoliduara artistike dhe teknike. Historia e koncertit të fundvitit fillon në vitin 2008, ku një grup artistësh ringritën pas shumë vitesh orkestrën simfonike dhe shfaqën në sallën e Teatrit "Migjeni" koncertin e parëtë titulluar "Ndërmendje" dhe nga ajo kohë në fund të dhjetorit zhvillohet çdo vit kjo premierë.</p> <p>"Ndërmendje" është një koncert i karakterit klasik, në të cilin ekzekutohen pjesë nga autorët më të njohur nga vendi dhe bota. Çdo vit repertori i këtij koncerti pasurohet dhe është gjithmonë i dashur për publikun Shkodran, duke i qëndruar besnik karakterit të tij festiv dhe klasik.</p> <p>Koncerti pasurohet edhe me pjesëmarrjen e artistëve më të shquar vendas dhe të huaj, të ftuar si solistë, apo orkestrantë.</p> <p>"Ndërmendje" është aktivitet, icili përfshin të gjithë artistët e kualifikuar të qytetit të Shkodrës dhe jashtë tij. Ruajtja e kësaj tradite, e bën Bashkinë Shkodër pjesë të modelit më të mirëtë vendeve europiane, të cilat realizojnë çdo vit koncertin e fundvitit.</p> <p>Eksperienca ka treguar që ky projekt kulmon festimet e fundvitit dhe ka pjesëmarrje të gjerë të spektatorëve. Nga eskperienca e viteve të tjera mund të thuhet që "Ndërmendje" është një ndër aktivitetet më të rëndësishme të vitit,sepse përfshin një masë të gjerë të institucioneve kulturore dhe pothuajse të gjithë artistët e qytetit tonëdhe jo vetëm.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe promovimi i vlerave të muzikës së kultivuar nëpërmjet interpretimit profesional; • Aktivizimi iformacioneve klasike; • Pasurimi i repertorit klasik, për artistët dhe artdashësit; • Zhvillimi dhe gjallërimi i jetës artistike, kulturore në qytet, gjatë festave të fundvitit. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Shpallja e ftesës së hapur për pjesëmarrje në konkurim për realizimin e projektit, • Vlerësim i propozimeve nga ana e Këshillit Artistiko- Kulturor, të Bashkisë Shkodër, • Marrëveshje për organizimin e të gjithë aktivitetit ndërmjet stafit të Bashkisë Shkodër dhe subjektit fitues, • Nxitja për zhvillim të aktivitetit në parametrat e kërkuar në Ftesën e Hapur, • Organizimi i aktivitetit, • Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivizimi i orkestrës simfonike, • Rritja e nivelit muzikor dhe bashkëpunimi ndërmjet artistëve, • Kultivimi i muzikës klasike, • Promovimi i turizmit kulturor. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Stafi i Qendrës Kulturore "Pjetër Gaci" Stafi i Teatrit "Migjeni" Artistë dhe grupe të ndryshme artistike				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:			
A1	Zhvillimi i aktivitetit "Ndërmendje" (shitese)	700	Paga	Sigurime	Operative	Kapitale
	Shuma	700			700	
f) Periudha e zbatimit Janar – Dhjetor 2023				Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Institucionilikuadues: Bashkia Shkodër		

Nr.	P08220.Q1.O3.A42 100 vjetori i Simon Gjoni	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.				
i. Situata						
<p>Simon Gjoni kompozitor, u lind në qytetin e Shkodrës më 28 tetor 1925. Talenti i Simon Gjoni spikati që kur ishte i ri dhe kur kontribuoi si drejtues i shumë formacioneve të ndryshme orkestrale dhe vokale të qytetit të Shkodrës. Me një sensibilitet dhe originalitet të dukshëm në kompozicion ai krijoi në vitet 1946-1947 një seri këngësh të paharruara që shquhen sa për ndjeshmërinë e tyre sa poetike aq edhe të sinqerta, të figurshme dhe fisnike si, "Lule bore", "Sy larushes", "Sytë e tu si drita", "Fyelli i çobanit", "Nëna dhe çika" etj. Në Moskë, në vitin 1956 trio Mula, Athanas, Tukiçi, korri sukses të jashtëzakonshëm me këngën Lule bore, në Vjenë në vitin 1961 festivali i rinisë u çel me introduksionin e Lule Bore.</p> <p>Simon Gjoni studimet e larta i kreu në Akademinë e Lartë muzikore të Pragës, në klasën e dirizimit simfonik me profesorët V. Smetacek, R. Brook, A. Klima. Në vitin 1954, ai ishte pjesëmarrës si kompozitor në Festivalin Ndërkombëtar të Muzikës, së bashku me kolosët botërore si Shoporin, Janson, Rihter, Fisher, Fournet etj. Në vitin 1956 në sallën "Mestska Knihovna" dirigjon Shubert "Rosamunda" dhe Grieg "Perr Gynt". Po në këtë kohë dirigjon veprën "Pygmalion" të kompozitorit Jiri Benda. Në vitin 1957 në sallën "Dum Umelco" ai drejtoi "Simfoninë orkestrale për violinë e kontrabas" të K. Dittersdorf. Suksesi i këtij koncerti pasohet nga ai i pjesës simfonike të Franc Listzi-it "Les Preludes". Simon Gjoni, është një ndër dirigjentët e parë të orkestrave tona simfonike të Teatrit të Operas dhe Baletit dhe të Radio-Televizionit Shqiptar. Në vitin 1958, kur u emërua dirigjent në TOB, shumë vepra të shquara e gjetën interpretimin e "parë" tek dirigjenti i ri, i cili interpretoi ato duke zbuluar ngarkesën emocionale të tyre me një ndjeshmëri të lartë. Përmendet baleti "Lola", "Laurencia", operat "Don Paskuale", "Berberi i Seviljes", "Paliacot", "Franceska da Rimini", "Pranvera", etj.</p> <p>Sa më sipër bashkia Shkodër për 100 vjetorin e lindjes do realizojë një ekspozitë promovuese monografie me ceremoni vlerësimi për këtë figurë të shquar të qytetit tonë.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<p>Evidentimi i vlerave dhe figurave që kanë shenjë në historinë e artit dhe kulturës në qytetin e Shkodrës. Njohja e të rinjve me këto figura përmes ekspozitës dhe muzikës së tij.</p>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<p>Ekspozitë Monografi Ceremoni</p>						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja dhe përcjellja e historisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike; • Nxitja e studimeve ndaj këtyre çështjeve në ditët e sotme; • Rikthimi i vëmendjes së publikut tek këto elemente të veçantë të trashëgimisë kulturore. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi"; • Studiues dhe pedagogë të fakultetit të arteve Shkodër; 				<p>Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm</p>		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
a.1	Organizim Ekspozitë, promovim monografie dhe ceremoni vlerësimi	300	Paga	Sigurime	Operative	Transfer Kapital
	Shuma	300			300	
f) Periudha e zbatimit Janar-Dhjetor 2023			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr.	P08220.Q1.O3.A43 Festivali Muraleve Realizimi i muraleve	Funksioni 8 Argëtim, Kultura dhe Feja N/funksioni 082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.					
i. Situata							
Muralet janë kthyer në atraksionin më të ri turistik në disa qytete të vendit, ku syri kureshtar i qytetarëve mahnitet nga ngjyrat, ndërthurja e elementëve dhe sidomos nga mesazhet që transmeton ky art. Këtë vit edhe në Shkodër një hapsirë e vecante do të dedikohet artisteve të rinj të cilët do të realizojnë piktura murale në zona të ndryshme të qytetit si ato industriale, duke i dhënë një pamje të re asaj zone.							
ii. Synimi i projektit							
Evidentimi i vlerave artistike të artistëve të arteve pamor duke i kthyer zonat industriale në pika të atraksionit kulturor.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
Realizimi i muraleve në zonat industriale dhe sallahaneve							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> • Kthimi i zonave industriale dhe sallahane në pika të atraksionit kulturor. 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> • Studentët e Universitetit "Luigj Gurakuqi"; • Studiues dhe pedagogë të fakultetit të arteve Shkodër; 				Bashkia Shkodër Donatorë të mundshëm			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transfer	Kapital
1	Blerje të materialeve të ndryshme	300			300		
2	Honorar për artist street art (8*62.5)	500			500		
Shuma		800			800		
f) Periudha e zbatimit Janar-Dhjetor 2023			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja Ekonomike e Kulturës Muzeu Historik, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.30	P08220.Q1.O3.A44 "Shkodra qyteti i festave"	Funksioni 8 Argëtim Kultura dhe Feja N/funksioni082 Shërbime kulturore Lloji i programit 08220 Trashëgimia kulturore aktivitetet artistike e kulturore.					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> i. Situata <p>Për festat e fundvitit sheshi i pedonale së qytetit do jetë qendra e festave të fundvitit në Shkodër. Një ambient i improvizuar me shtëpiza druri, të cilat do vendoset në pedonalen e qytetit do krijojnë një atmosferë festive me muzikë, ekspozitat pikturore, kartolina dhe panairtë artizanale. Festimet e shumta rreth shtëpizave të drurit, ceremonia e ndezjes së dritave në qytet, dekorimet dhe dhuratat e bëjnë këtë periudhë të vitit shumë të veçantë. Kjo atmosferë festive që përjetojnë fëmijët dhe të rriturit gjatë këtyre festave është një vlerë e shtuar për qytetin e Shkodrës</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi dhe gjallërimi i qytetit në muajin e festive të fundvitit; Krijimi i sheshit të pedonale si pikë atraktive për turizmin, Blerja dhe Vendosja e disa shtëpizave për promovimin e bizneseve të ndryshme në qytet 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i aktivitetit, Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Pasurimi i atmosferës festive të fundvitit, Nxiltja e atraksionit për turistët që vizitojnë vendin tonë, Inkurajimi i biznesit për t'u afruar me formate të tilla, Argëtimi i qytetarëve. 							
d) Aktorët e mundshëm		e) Kontributet e mundshme në projekt					
Subjekte të ndryshme që zhvillojnë aktivitete artistiko-kulturore, Artistë dhe grupe të ndryshme artistike, Komuniteti		Bashkia Shkodër Shoqata artistike. Donatorë të mundshëm					
e) Shpenzime të llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktivite per femije e te rritur, muzikal festiv per femije, koncerte ne shesh gjate muajit festiv	2000			2000		
A.2	Blerje e shtepizave per aktivite promovuese	1.500					1.500
	Shuma	3.500			2000		1.500
f) Periudha e zbatimit janar -dhjetor 2023		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni Likuidues: Bashkia Shkodër					

P09120.O3 .A6. Ndërtim- shtesë e godinës për shkollën Ismet Sali Bruçaj, Guci e RE, Njesia Rethina (shtese)

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit te projektit	Drejtoria Ekonomike e Arsimit	Firma e propozuesit te Projektit	
Te dhëna te detajuara për propozuesin e projektit			
Institucioni Buxhetor Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodër	Vendodhja e Projektit	Shkodër

02. Identifikimi i Idesë se Investimit

Projekt Idea	Rikonstruksion Shkolla Ismet Sali Bruçaj
Problemet për tu adresuar	Objekti i ri eshte i papërfunduar, eshte kryer vetëm çatia dhe muret Mungesa e dyerve dhe dritareve tek objekti i Mungesa e rrjetit elektrik tek objekti i ri Mungesa e shtresave te plakava dhe suvasë Mungesa e tualeteve dhe e sistemi KUZ
Emri i Programit	Arsimi baze
Qëllimet dhe objektivat e Programit te cilat projekti do te ndihmoje te arrihen	Perfundimi i rikonstruksionit te fazës se dyte, me shtimin e ambienteve duke shmangur mësimin me dy turne, dhe largimin e nxënësve ne shkolla te tjera. Duke ofruar nxënësve mësim me kushte me dinjitoze

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

Kosto Totale e Projektit 000/leke	8 461
Kosto e zbatimit	8 461
Kosto e supervizim	0
Kosto Kolaudim	0
Kosto Projektim	0

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit te projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)				Aprovimi / refuzimi për tu shqyrtuar me tej
Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) Institucioni Likuidues ; Drejtoria Ekonomike e Arsimit Investimi do të realizohet: ne vitin 2023				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit te projekt idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka)				